



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 83
Datë: 25/1/2022

Në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas neneve 17 dhe 23 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe pikës II të Vendimit me nr. prot. 82, datë 25.1.2022 të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Këshilli Drejtues i UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Z. Besfort Krasniqi, sekretar i Fakultetit të Filologjisë, caktohet në cilësinë e ushtruesit të detyrës së sekretarit të përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm.
- II. Ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm i gëzon të gjitha të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Statutin e UP-së dhe dispozitat ligjore në fuqi.
- III. Gjatë ushtrimit të detyrës së sekretarit të përgjithshëm, z. Besfort Krasniqi, do të kompensohet në përputhje me rregulloret në fuqi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Rektori, në cilësinë e autoritetit kryesor menaxhues në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", duke u mbështetur në Vendimin me nr. prot. 82, datë 25.1.2022 të Këshillit Drejtues të UP-së, me qëllimin kryesor efikasitetin në punë dhe kryerjen e detyrave të punës siç kërkohet me Statutin e UP-së dhe aktet ligjore të zbatueshme në fuqi, ka propozuar kandidatin për ushtrues të detyrës së sekretarit të përgjithshëm për periudhën deri në përfundimin e procedurave të konkursit të brendshëm publik për përzgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm. KD-ja konsideroj të arsyeshëm propozimin e rektorit dhe vendosi që z. Besfort Krasniqi të jetë ushtrues detyre i sekretarit të përgjithshëm të UP-së, deri në përfundimin e procedurave të konkursit për përzgjedhjen e sekretarit të përgjithshëm. Andaj, nga ajo që u tha më lart, Këshilli Drejtues i UP-së mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Anëtarëve të Këshillit Drejtues të UP-së,
3. Menaxhmentit të UP-së,
4. U.D. së sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
5. Shërbimit të financave në UP,
6. Zyrës ligjore në UP.

Këshilli Drejtues i UP-së:
Dr. Arbëresha Nela Turjaka, kryesuese